



## **Marrëveshje bashkëpunimi**

### **Meridian Express dhe Fakulteti i Ekonomisë**

Meridian Express Sh.p.k. dhe Fakulteti i Ekonomisë, nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit me datë 08.05.2024, nr. i prot. 17/118. Kjo marrëveshje bashkëpunimi është hartuar me qëllim të formalizimit të bashkëpunimit ndërmjet Meridian Express dhe Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Prishtinës, për të forcuar lidhjet ndërmjet dy institucioneve dhe për të mbështetur zhvillimin e përbashkët akademik dhe profesional. Fakulteti i Ekonomisë dhe Meridian Express pajtohen që, për interesa të përbashkëta, të asistojnë, promovojnë, përkrahin dhe ngritin nivelin e bashkëpunimit reciprok mes tyre, në funksion të zhvillimit të përgjithshëm të sistemit edukativo-arsimor, hulumtues dhe shkencor, për të ndihmuar përgatitjen e studentëve për tregun e punës.

Linku: <https://meridianexpress.com/>